



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.07, datë 10.06.2021

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“OBJEKT ME FUNKSIONE KOMPLEKSE, SHËRBIM, HOTELERI DHE**  
**REZIDENCIAL”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË**

Në mbështetje të neneve 7, shkronja “ç”, 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive “EB Construction” sh.p.k dhe “AgroRoma 2019” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**


1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Objekt me funksione komplekse, shërbim, hoteleri dhe rezidencial”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “EB Construction” sh.p.k dhe “AgroRoma 2019” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

A large, stylized handwritten signature in blue ink is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHqipërisë" at the top and "MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË" at the bottom. The signature is written in a cursive style, starting from the left and ending with a small flourish on the right.

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOFA

